



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve –Ministartstvo za Finansija, Rada i Transfera  
Ministry of Finance, Labor and Transfers  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

# **HARTA RRUGORE E ASK-së**

## **PËR VITIN 2022**

**Dhjetor, 2021**  
**Prishtinë**

## PARATHËNIE

Ky dokument përmban planin e veprimit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) dhe është i bazuar në Planin Vjetor të Statistikave Zyrtare për vitin 2022 të ASK-së, si dhe në Programin e Statistikave Zyrtare 2018-2022, të cilat janë miratuar nga Qeveria e Kosovës.

Edhe gjatë vitit 2022, ASK, ja do të jetë e fokusuar në: zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022; zbatimin e Planit Vjetor të Statistikave Zyrtare 2022; Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive familjare dhe banesave; zbatimin e Planit të Veprimit për realizimin e rekomandimeve të Raportit “Peer Review 2017”; avancimin e sistemit të planifikimit dhe të monitorimit përmes Sistemit të SIPK-ut; zbatimin e ligjeve, akteve nënligjore, të rregulloreve ekzistuese dhe ato që priten të aprovohen; ngritjen e kapaciteteve në ASK, posaçërisht në statistikat sociale, fushën e llogarive kombëtare, statistikat ekonomike, statistikat e bujqësisë, në TI dhe në mbledhjen e të dhënave. Riorganizimi i ASK, si pjesë e procesit të përgjithshëm të reformës së administratës publike, është në agjendën e vitit 2022

Në këtë dokument janë paraqitur aktivitetet më të rëndësishme të ASK-së, që janë të bazuara në planet dhe detyrat e rregullta, të paraqitura në formë të proceseve rrugore të integruara. Përderisa, planet më të detajuara ekzistojnë në dokumentet e brendshme të departamenteve përkatëse të ASK-së.

Në pjesën e parë të vitit 2022, sipas dispozitave nga Ligji për Statistikat Zyrtare, ASK-ja do ta përgatisë Raportin Vjetor, ku do të përfshihet performanca e departamenteve, respektivisht arritjet në ASK dhe në Sistemin Statistikor të Kosovës gjatë vitit 2021. Dallimet eventuale, ndërmjet asaj që është planifikuar dhe asaj që është realizuar, barten si pjesë e planit për vitin vijues. Sipas Ligjit të Statistikave Zyrtare të Kosovës, Raporti Vjetor dërgohet në Qeveri dhe në Kuvendin e Kosovës për miratim.

---

\* Planet e detajuara nënkuptojnë dokumentet, që i kanë departamentet përkatëse, të cilat cilësohen si “fletë punuese”.

# PËRMBAJTJE

	Faqe
1. ORGANIZIMI I ASK-së.....	4
1.1 Aktivitete të rëndësishme, që priten të finalizohen në 2022.....	5
2. KËSHILLI STATISTIKOR .....	5
3. ZHVILLIMI I DEPARTAMENTEVE SIPAS PLANIT VJETOR 2022 .....	6
3.1 Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim.....	6
3.2 Fushat e mbështetura nga donatorët.....	7
3.3 Departamenti i Llogarive Kombëtare .....	9
3.4 Departamenti i Statistikave Ekonomike.....	11
3.5 Departamenti i Statistikave Sociale .....	13
3.6 Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit.....	15
3.7 Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informative .....	16
3.8 Departamenti i Anketimeve dhe Regjistrimeve .....	19
3.9 Departamenti i Administratës.....	20
4. SFIDAT .....	21
5. SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE DHE QASJA.....	21
6. BUXHETI .....	26
Aneksi 1 - Organogrami i ASK-së.....	27

## 1. ORGANIZIMI I ASK-së

Me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe funksionilitetit të strukturës organizative dhe në zbatim të vendimeve të Qeverisë për Reformën e Administratës shtetërore, ASK, ka përgatitur draft rregulloren nr. ../2021 Për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në agjencinë e statistikave të Kosovës. Pas aprovimit nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ASK për vitin 2022, parashih zbatimin dhe funksionalizimin e sipas dispozitave të rregullores së lartcekur.

Në aspektin e plotësimit të nevojave të përdoruesve me të dhëna statistikore të sakta, të besueshme, në kohë dhe të krahasueshme ndërkombëtarisht, ASK-ja gjatë vitit 2022 do të vazhdojë të rrisë kapacitetet njerëzore dhe profesionale.

Sipas Ligjit për Statistikat Zyrtare, Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022, Planit të Veprimit për realizimin e rekomandimeve nga Raporti “Peer Review”, MSA-së, PKZMSA, Planit të punës së Qeverisë, PSO, etj, ASK-ja ka obligime dhe përgjegjësi të mëdha në ngritjen edhe zhvillimin e Statistikave Zyrtare në nivel vendi, në harmoni me rekomandimet dhe standardet ndërkombëtare statistikore duke përfshirë edhe legjislacionin sekondar.

ASK-ja do të kryej edhe detyra për çështje të tjera, që parashihen me Ligj dhe me aktet nënligjore.

Aktivitetet me qasje dinamike dhe reformim të vazhdueshëm, gjatë vitit 2022 ASK-ja planifikon:

- Përcaktimin dhe zhvillimin e metodologjisë statistikore, klasifikimin dhe përdorimin e standardeve ndërkombëtare për prodhimin dhe publikimin e Statistikave Zyrtare;
- Hartimi dhe dërgimin e planit të tretë të Statistikave Zyrtare 2023-2027;
- Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2021/2022;
- Hartimi dhe dërgimin e Planit Vjetor të Punës për vitin 2023 në Qeveri për aprovim;
- Ta paraqesë për miratim Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, Raportin Vjetor 2021 mbi zbatimin e Planit të Punës, programit dhe shfrytëzimin e mjeteve buxhetore. Raporti Vjetor i miratuar do të publikohet;
- Fuqizimin e bashkëpunimit me organizatat vendore dhe ndërkombëtare, kompetente për Statistikat Zyrtare, me qëllim që të mundësohet krahasimi i Statistikave Zyrtare të Kosovës me statistikat e prodhuara në sisteme të tjera statistikore;
- Të rris sasinë dhe cilësinë e Statistikave Zyrtare përfshirë modernizimin e proceseve për mbledhjen e të dhënave statistikore;
- Zhvillimin dhe inventarizimin e indikatorëve në kuadër të Agjendës SDG 2030 si dhe rritjen e koordinimit dhe komunikimit në kuadër të Sistemit Statistikor të Kosovës,

## 1.1 Aktivitete të rëndësishme, që priten të finalizohen në 2022

- Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë ( të gjitha aktivitetet parapërgatitore dhe përgatitore që kanë të bëjnë me realizimin e Projektit të Regjistrimit të Popullsisë 2022);
- Vazhdimi i rritjes së kapaciteteve administrativo-profesionale të ASK,-së përmes rekrutimit të stafit të ri respektivisht trajnimeve të ndryshme në fushën e statistikave;
- Vazhdimi i modernizimit të procesit të mbledhjes së të dhënave si dhe rritja e kualitetit të prodhimit të Statistikave Zyrtare gjegjësisht statistikave sociale, llogarive kombëtare, ekonomike, të bujqësisë dhe sistemeve të TI-së.
- Përafrimi me ACQUIS -zgjerimi i zbatimit të metodologjisë së Eurostat gjegjësisht prodhimi i statistikave sipas standardeve ndërkombëtare, ;
- Avancimi dhe zbatimi i Kornizës së Vlerësimit të Performancës (Projekti i SIPK-ut) në funksion të vendimmarrjes bazuar në fakte nga top menaxhmenti i ASK-së.
- Shkurtimi i afateve kohore në prodhimin e Statistikave Zyrtare me theks të veçantë në prodhimin e statistikave tremujore të BPV-së dhe statistikave tremujore të Tregut të Punës;
- Vlerësimi i ekonomisë joformale sipas aktiviteteve ekonomike në harmoni me metodologjinë e Eurostatit ;
- Publikimi për herë të parë i të dhënave nga ekonomia e pa vrojtuar;
- Aprovimi nga ana e Qeverisë dhe zbatimi i akteve nën ligjore respektivisht dy udhëzimeve administrative (Draft UA, për të dhënat statistikore konfidenciale dhe draft UA për shitjen e të dhënave statistikore) në përputhje me Ligjin e Statistikave Zyrtare dhe plotësim ndryshimin e tij,
- Miratimi i Ligjit, për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe banesave, 2022 (kohe optimale viti 2021);
- Zbatimin e aktiviteteve nga projekti katërvjeçar Përkrahje Sistemit Statistikor të Kosovës, përkrahur nga BE-SIDA, etj.

## 2. KËSHILLI STATISTIKOR

Këshilli është themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në baze të Ligjit mbi Statistikat Zyrtare. Funkcionet e Këshillit janë (është themeluar) për të dhënë këshilla për përgatitjen dhe zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare dhe për zhvillimin e përgjithshëm dhe funksionimin e ASK-së. Këshilli Statistikor përbëhet nga dymbëdhjetë (12) anëtarë dhe Kryeshafi Ekzekutiv i

ASK-së, që përfaqësojnë institucionet kyçe, universitetet, komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile

Këshilli i Ri Statistikor që është formuar me Vendim të Qeverisë së Kosovës gjatë vitit 2019 me mandat 5 vjeçar, sipas Rregullores për funksionimin e tij, do të jep rekomandime lidhur me proceset e zhvillimit të Statistikave Zyrtare. Takimet e rregullta mbahen çdo tre muaj. Gjatë vitit 2022, bazuar në rregulloren për funksionim të Këshillit planifikohen 3-4 takime gjatë vitit. Për më tepër bazuar në funksionet e Këshillit, ASK, planifikon që përmes mekanizmit të KS, me rre këshilla dhe sugjerime lidhur me hartimin e Planit 5 Vjeçar të Statistikave Zyrtare 2023-2027, Plani vjetor 2023, regjistrimin e popullsisë, raportin , kriteret për Statistika Zyrtare, etj.

### **3. ZHVILLIMI I DEPARTAMENTEVE SIPAS PLANIT VJETOR 2022**

Një ndër qëllimet e ASK-së është ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve profesionale me qëllim të prodhimit të Statistikave Zyrtare sipas standardeve dhe metodologjive të kërkuara nga Eurostat. Ky zhvillim i departamenteve do të bëhet në pajtim me planin zhvillimor të ASK-së si dhe politikave të diseminimit për: rritjen numrit dhe cilësisë së Statistikave Zyrtare; evitimin e të gjitha gabimeve të mundshme në publikimet e ASK-së; zhvillimin e mëtejshëm të metodologjive dhe teknologjisë statistikore; zhvillimin e politikave të standardizimit dhe mbështetjen në përvojat e fituara me ekspertë ndërkombëtarë për zbatimin e këtyre standardeve.

Më poshtë janë dhënë proceset rrugore sipas departamenteve për vitin 2021.

#### **3.1 Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim**

Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit janë të përshkruara në Rregulloren për Riorganizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës së Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK). Përgjegjësitë kryesore të DPPKK, konsistojnë në procesin e planifikimit, monitorimit, komunikimit dhe koordinimit të aktiviteteve si brenda dhe jashtë ASK-së. Hartimi dhe zbatimi politikave në fushën e statistikave, përmirësimi dhe avancimi i bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, ne veçanti me Eurostat, koordinimi (brenda ASK-së dhe Sistemit Statistikor të Kosovës), monitorimi i proceseve operative dhe strategjike si dhe komunikimi me përdoruesit e Statistikave Zyrtare paraqesin pikat kryesore në kuadër të përgjegjësisë të departamentit në fjalë.

Vendimmarrja bazuar në të dhëna është një nga qëllimet e ASK-së, prandaj sigurimi i informacioneve (të dhënave analitike) për Kryeshëfën Ekzekutiv të ASK-së lidhur me performancën e departamenteve prodhuese dhe mbështetëse në ASK është një nga detyrat

parësore të këtij departamenti. Në këtë kontekst, edhe gjatë vitit 2022, do të ofrohen të dhëna analitike mbi performancën e proceseve prodhuese përmes të dhënave nga sistemi i SIPK-ut dhe burimeve të tjera mbi bazën e të cilave do të ofrohen informacione të nevojshme për top menaxhmentin e ASK-së.

Disa nga aktivitetet më të rëndësishme të cilat priten të realizohen nga DPPKK për vitin 2022 janë si në vijim: Incimi dhe koordinimi i proceseve me stafin tjetër në ASK dhe anëtarët tjerë të Sistemit Statistikor për draftimin e Planit të tretë 5 Vjeçar të Statistikave Zyrtare 2023-2027, hartimi i planit vjetor të Punës Vjetor 2023, monitorimi i zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022, Zbatimi/monitorimi i aktiviteteve në kuadër të programit kombëtar të MSA-së dhe PKZMSA 2022 në fushën e statistikave, zbatimi dhe monitorimi i aktiviteteve në kuadër të planit vjetor të punës së qeverisë (PVPQ 2022), në fushën e statistikave, zhvillimi, inventarizimi dhe koordinimi me partnerët tanë të jashtëm lidhur me agjendën SDG 2030, vazhdimi i monitorimit nga zbatimi i Planit të Veprimit për realizimin e rekomandimeve nga “Peer Review 2017”, për vitin 2022, hartimi dhe lëshimi i komunikatave nga ASK-ja me interes për shfrytëzuesit etj. Në kuadër të përgatitjeve për Regjistrimin e Popullsisë 2022, DPPKK sipas përgjegjësisë të caktuara, do të jetë në funksion të detyrave dhe përgjegjësisë të saj për të përmbushur me sukses të gjitha aktivitetet e parapara me planin e punës në kuadër të zyrës së regjistrimit të popullsisë.

Avancimi i një sistemi dialogues me shfrytëzuesit e të dhënave zyrtare, në mënyrë që të adresohen kërkesat e shfrytëzuesve nga pikëpamja e cilësisë dhe vëllimit të të dhënave statistikore do të jetë pjesë e proceseve rrugore të DPPKK-së gjatë vitit 2022.

### **3.2 Fushat e mbështetura nga donatorët**

Ndihma e donatorëve ka dhënë vazhdimisht ndikim në ngritjen e kapaciteteve të stafit dhe në përmirësimin e produkteve statistikore të ofruara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, për institucionet dhe përdoruesit e statistikave në tërësi.

Në kuadër të mbështetjes nga donatorët, ASK-ja ka bashkëpunim të vazhdueshëm me EU, SIDA/SCB, FMN, UNFPA, UNICEF, UNDP, etj. Prandaj fushat e bashkëpunimit do të jenë:

- Ngritja e kapaciteteve dhe ndihma në fushën e projekteve do të jetë e vazhdueshme dhe me shumë interes për ASK-në. Gjatë vitit 2022, donatorët do të vazhdojnë ta mbështesin stafin në ngritjen e kapaciteteve në shumë aktivitete të ndryshme, me numër të konsiderueshëm pjesëmarrjeje në të gjithë sektorët e statistikave. Vazhdimi i mbështetjes së stafit të ASK-së për pjesëmarrje në takime, konferenca, trajnime, takime pune, grupe të punës, që janë të planifikuara në instrumentin planifikues të aktiviteteve, MC-listë dhe nga

Katalogu i takimeve “European Statistical Training Programme ESTP” mbështetur nga Eurostat-i dhe organizatat e tjera për vitin 2022.

- Koordinimi i aktiviteteve në baza mujore, për takimet e stafit të ASK-së, realizimi i takimeve, aprovimet dhe raportet e aktivitetit, etj.

Komisioni Evropian përmes Programit IPA 2019 (i planifikuar për periudhën dy vjeçare), gjatë vitit 2021-2024 do të vazhdojë ta mbështesë ASK-në me 18 projekte statistikore:

### **Projektet statistikore me IPA 2019 periudha implementuese 2021-2023**

1	Statistikat e financave të qeverisë dhe deficitit të tepërt
2	Statistikat e Tregtisë Ndërkombëtare të Shërbimeve
3	Llogaritë Kombëtare - Metodologjia
4	Programi i Transmetimit, Llogaritë Kombëtare Vjetore, Llogaritë Kombëtare Tremujore
5	Llogaritë e sektorit
6	Tabelat e furnizimit, përdorimit dhe hyrje-daljet (SUT/IOT)
7	Statistikat e çmimeve - IHÇK
8	Statistikat e çmimeve - PPP
9	Regjistrat e Biznesit
10	IPA PP 3.2 mbi Statistikat Afatshkurtra të Biznesit
11	Statistikat e Tregtisë Ndërkombëtare të Mallrave
12	Anketa e fuqisë punëtore
13	Llogaritë mjedisore dhe pylltaria
14	Statistikat e mbeturinave
15	Menaxhimi i cilësisë
16	Zbatimi i standardeve për meta të dhënat dhe shkëmbimin e të dhënave
17	Komunikimi
18	Raportimi i aktiviteteve horizontale

- Do të vazhdohet me aktivitetet rreth realizimit të projekteve statistikore duke koordinuar aktivitete si: ToR, kontrata, fatura, raportet e ndërmjetme, raportet finale, misione të eksperteve dhe të të gjitha aspekteve tjera koordinuese që dalin gjatë implementimit të programit IPA në realizimin e plotë për secilin projekt statistikor.
- Koordinimi i aktiviteteve me departamentet në kuadër të dërgimit të të dhënave vjetore në Eurostat për treguesit e shumtë statistikorë, dy runde brenda vitit “Mbledhja e të dhënave”.
- Koordinimi i aktiviteteve me departamentet dhe BQK-ne në kuadër të mbledhjes dhe plotësimit të të dhënave në nivel modular për SMIS+ në baza vjetore (Meta data Handler).
- Vazhdimi i bashkëpunimit me donatorët dhe koordinimi i aktiviteteve në kuadër të projekteve të mbështetura nga donatorët.
- Bashkëpunimi me departamentet dhe realizimi në kohë i kërkesave të ndryshme për proceset statistikore, nga vendet e BE-së dhe të rajonit.



Përveç listës së mësipërme të pilot projekteve që janë në funksion të ngritjes së kapaciteteve profesionale të ASK nga Instrumenti i Para anëtarësimit MB IPA programe. Gjithashtu në ASK, është duke u zhvilluar edhe projekti në nivel bilateral ( kombëtar) përmes bashkëfinancimit nga projekti i BE-SIDA për periudhën 4 vjeçare 2019-2023. ASK, ja falë bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët ndërkombëtar është duke u përkrahur edhe nga donatorë të tjerë si UNICEF, UNFPA, EB, IMF, etj.

### **3.3 Departamenti i Llogarive Kombëtare**

Departamenti i Llogarive Kombëtare (DLLK) përbëhet nga dy divizione: Divizioni i Llogarive Kombëtare dhe Divizioni i Ekonomisë Joformale dhe Llogarive qeveritare.

Ne planin e vitit 2022, departamenti ka këto prioritete: rritjen e numrit të tabelave të dërguara ne Eurostat, publikimin e rregullt të të dhënave të bruto produktit vendor ne baza vjetore me çmime aktuale dhe çmime të vitit paraprak (sipas dy qasjeve), publikimin e të dhënave të bruto produktit vendor ne baza tremujore ne afat T+75 dite, përpilimin e llogarive kombëtare sipas qasjes së të ardhurave; përgatitja e të dhënave të Llogarive kombëtare sipas Programit të Transmetimit sipas ESA 2010, si dhe respektimi i afateve kohore ne transmetimin e të dhënave (transmetimi i të dhënave duke përdorë platformën SDMX-RI), përlllogaritja e BPV-së sipas efekteve sezonale dhe zingjimore, përlllogaritja e shpenzimeve të konsumit final të ekonomive familjare sipas qëndrueshmërisë, përpilimi i Llogarive sektoriale; përpilimi i llogarive kombëtare Regjionale; përpilimi i llogarive kombëtare sipas tabelave Ofruese-Përdoruese (SUT); publikimi i indikatorëve MIP; përgatitja e metadatave të llogarive kombëtare; përgatitja e metodologjisë së llogarive kombëtare vjetore me çmime aktuale, konstante dhe llogarive kombëtare tremujore; përgatitja e metodologjisë së llogarive sektoriale, kryerja e punëve të pilot-projekteve IPA 2019. Me mbështetjen e Projektit të BE/SIDA do të punohet ne përpilimin e llogarive kombëtare sipas tabelave Ofruese-Përdoruese (SUT) për vitin 2019 dhe ne përlllogaritjen e të dhënave të formimit të bruto kapitalit fiks (tabela 0302).

Sa i përket Divizionit të Ekonomisë Joformale dhe Llogarive qeveritare, në vitin 2022 ka këto prioritete: vlerësimin e ekonomisë joformale në bazë të auditimit fiskal sipas aktiviteteve ekonomike për të gjitha seritë kohore të BPV-së; vlerësimin e ekonomisë joformale në bazë të Metodës së Inputit të Punës (Labor Input Method) sipas aktiviteteve ekonomike për të gjitha seritë kohore të BPV-së; vlerësimin e trafikimit të drogës; vlerësimin e ekonomisë joformale për të vetëpunësuarit; krijimin e një sistemi të qëndrueshëm për prodhimin e statistikave të ekonomisë joformale; integrimin e rezultateve në sistemin e Llogarive kombëtare duke siguruar

kështu mbulueshmëri të plotë të llogarive kombëtare, dokumentimin e proceseve statistikore; rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, etj; publikimin e llogarive qeveritare sipas metodologjisë së ESA 2010; rritjen e numrit të tabelave dhe e transmetimin e të dhënave për llogaritë qeveritare në Eurostat; përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së të dhënave; shkurtimin e afateve kohore për publikimet e llogarive qeveritare; kryerjen e detyrave në kuadër të pilot-projekteve të IPA 2019 si dhe vazhdimin e aktiviteteve në kuadër të Asistencës teknike me Projektin Nacional IPA për Llogaritë kombëtare dhe në kuadër të Projektit të SIDA-BE për Llogaritë Kombëtare.

Më poshtë është lista e publikimeve nga Departamenti i Llogarive Kombëtare të palnifikuara për vitin 2022.

Muaji i botimit	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gush	Sht	Tet	Nën	Dhj
Llogaritë Qeveritare			TM4/ 2021		Vjetore 2021	TM1 / 2022			TM2/ 2022			TM3 /2022
Bruto produkti vendor BVP-Qasja e Shpenzimeve & Prodhimit vjetore, seritë kohore te reviduara									2008- 2021			
BVP tremujore-Qasja e shpenz. dhe prodhimit			TM4/2 021			TM1/ 2022			TM2 2022			TM3 /2022

*Vëreni se muaji i shkruar në kutinë e bjezuar paraqet muajin/vitin e raportuar, përderisa muaji në krye të tabelës është muaji në të cilin publikimet priten të shpërndahen.*

Për përgatitjen e publikimeve ne kuadër te Departamentit te Llogarive Kombëtare, përfshihen disa faza te punës: mbledhja e te dhënave, përfshirja, vlerësimi i të dhënave, përpunimi dhe analiza e të dhënave, përgatitja dhe publikimi i rezultateve, ndërsa proceset rrugore janë te paraqitura ne tabelën e mësipërme.

Gjatë vitit 2022 planifikohen të realizohen edhe këto aktivitete:

- Në kuadër të IPA 2019 (MB)\* - Programi i bashkëpunimit statistikor shumë përfitues, gjatë vitit 2022 do të vazhdojnë këto projekte te llogarive kombëtare do te jenë në proces:
  - Statistikat e financave qeveritare (GFS/EDP)
  - Metodologjia e Llogarive Kombëtare (NAM);
  - Programi i transmetimit i te dhënave të Llogarive kombëtare vjetore, tremujore ne Eurostat dhe raportimi i cilësisë
  - Llogaritë sektoriale

- Projekti SUT/IOT (tabelat ofruese-përdoruese)
- Vlerësimi i ekonomisë joformale në kuadër të Projektit EU/SIDA).

### 3.4 Departamenti i Statistikave Ekonomike

Departamenti i Statistikave Ekonomike (DSE) përbëhet nga dy divizione: divizioni i Statistikave të Çmimeve dhe Divizioni i Statistikave të Ndërmarrjeve dhe Statistikave të Tregtisë së Jashtme.

Në planin e vitit 2022, departamenti ka këto prioritete: të vazhdoj me mbledhjen e të dhënave në mënyrë elektronike, shkurtrimin e afatit të publikimit të të gjitha publikimeve (muajore, tremujore dhe vjetore); fillimin e publikimeve të reja tremujore, transmetimin e të dhënave në Eurostat (shtimin e numrit të tabelave) për statistikat e transportit, turizmit dhe energjisë; përmirësimin e cilësisë së Regjistrit të Bizneseve; përmirësimin e statistikave afatshkurtra të turizmit; përmirësimin e statistikave afatshkurtra të transportit; përmirësimin e statistikave të çmimeve; aktivitetet për kryerjen e detyrave të pilot-projektet e IPA 2017 (MB) me projektet e veçanta të fushave përkatëse. Vazhdimin e aktiviteteve në kuadër të Asistencës teknike të Projektit Nacional IPA për Statistikat ekonomike.

Më poshtë është lista e publikimeve nga Departamenti i Statistikave Ekonomike në vitin 2022.

Muaji i botimit	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Statistikat e tregtisë së Jashtme	Dhj 2021	Jan 2022	Shk 2022	Mar 2022	Prill 2022	Maj 2022 & 2022 vj	Qer 2022	Kor 2022	Gush 2022	Sht 2022	Tet 2022	Nën 2022
Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit	Dhj 2021	Jan 2022	Shk 2022	Mar 2022	Prill 2022	Maj 2022 & 2020 vj	Qer 2022	Kor 2022	Gush 2022	Sht 2022	Tet 2022	Nën 2022
Statistikat e Hotelerisë			TM4 /2021			TM1 /2022			TM2 /2022			TM3 /2022
Indeksi i çmimit të importit			TM4 /2021			TM1 /2022			TM2 /2022			TM3 /2022
Bilanci i Energjisë në Kosovë		TM4 /2021			TM1 /2022			TM2 /2022			TM3 /2022	
Indeksi i çmimeve të prodhimit			TM4 /2021			TM1 /2022			TM2 /2022			TM3 /2022
Rep. stat mbi Ndërmarrjet në Kosovë		TM4 /2021			TM1 /2022			TM2 /2022				TM3 /2022
Statistikat e Transportit		TM4 /2021			TM1 /2022			TM2 /2022				TM3 /2022
Transporti Rrugor i mallrave					TM1 /2022			TM2 /2022				TM3 /2022
Rezultatet e Anketës Strukture të Ndërmarrjeve												2021vj.
Indeksi i Kostos së Ndërtimit			TM4 /2021			TM1 /2022			TM2 /2022			TM3 /2022
Statistikat tremujore për Industri			TM4/ Jan 2022	Shk 2022	Mar 2022	Prill 2022	Maj 2022	Qer 2022	Korrik 2022	Gush 2022	Sht 2022	Tet 2022
Statistikat tremujore për Tregti me Pakice			TM4/ Jan 2022	Shk 2022	Mar 2022	Pril 2022	Maj 2022	Qer 2022	Korrik 2022	Gush 2022	Sht 2022	Tet 2022

Statistikat e shërbimeve			TM4 /2021 Jan 2022	Shk 2022	Mar 2022	Pril 2022	Maj 2022	Qer 2022	Korrik 2022	Gush 2022	Sht 2022	Tet 2022
Statistikat për hulumtim dhe zhvillim R&D												2021 vj.
Statistikat e lejeve të ndërtimit			TM4 /2021			TM1 /2022			TM2 /2022			TM3 /2022
Rezultatet e Anketës së PRODCOM-it												2021 vj.
Rezultatet e Anketës së (TIK) në Ndërmarrje											2020 vj.	
Rezultatet e Anketës së Investimeve në Ndërmarrje												2021vj.

*Vëreni se muaji i shkruar në kutinë e bjezuar paraqet muajin/vitin e raportuar, përderisa muaji në krye të tabelës është muaji në të cilin publikimet priten të shpërndahen.*

Për përgatitjen e publikimeve në kuadër të Departamentit të Statistikave Ekonomike, përfshihen disa faza të punës: zgjedhja e mostrës, anketimi/mbledhja e të dhënave, kontrolli logjik, përfshirja, përpunimi, analiza dhe publikimi i të dhënave, ndërsa proceset rrugore janë të paraqitura në tabelën e mësipërme.

Gjatë vitit 2021 planifikohen të realizohen edhe këto aktivitete, sa i përket statistikave ekonomike:

Në kuadër të IPA 2017 (MB) - Programi i bashkëpunimit statistikor me shumë përfitues IPA 2017:

- Pariteti i Fuqisë Blerëse;
- Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit;
- Regjistri Statistikor i Biznesit;
- Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve
- Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve; përgatitja për FRIBS (Framework Regulation Integrating Business Statistics);
- Statistikat e Biznesit në BE në Gj. Angleze FRIBS (Framework Regulation Integrating Business Statistics);
- Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve dhe Demografisë e Ndërmarrjeve
- Statistikat e Tregtisë së Jashtme për mallra, dhe
- Statistikat e Transportit Rrugor të mallrave
- Statistikat Afatshkurta të Shërbimeve
- Statistikat për Hulumtim dhe Zhvillim - R&D (Research and Development) dhe GBAORD (Government Budget Appropriations or Outlays for Research and Development).

### 3.5 Departamenti i Statistikave Sociale

Departamenti i Statistikave Sociale (DSS) përbëhet nga dy divizione: Divizioni i Statistikave Sociale dhe Divizioni i Statistikave të Popullsisë, që janë përgjegjëse për prodhimin e statistikave sociale dhe statistikave të popullsisë.

Në planin e vitit 2022, departamenti ka këto prioritete:

- Përgatitjet për “Regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave” projekt i cili pritet të zhvillohet në Vjeshtë të vitit 2022. Bazuar në përvojën nga Regjistrimi i Popullsisë 2011 si dhe praktikat nga vendet e tjera, gjatë vitit 2022, do të vazhdojnë përgatitjet intensive të dokumenteve strategjike që ndërlidhen me Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2022.
- Hartimi i **“Regjistrimit të Popullsisë”** nga fundi i vitit 2020 kanë filluar takime me Institucionet e Republikës së Kosovës për të diskutuar rreth regjistrave të tyre përkatës (të cilët i posedojnë) dhe për shfrytëzimin e tyre për krijimin e **Regjistrimit të Popullsisë** ku do të përgatitet një dokument si do të duket Regjistri i popullsisë si dhe të përshkruhet se cilat variabla i posedojnë institucionet për ta krijuar një raport të detajuar për të vazhduar me tutje në krijimin e Regjistrimit të popullsisë (realizimi i projektit do të varet nga institucionet e tjera të Republikës së Kosovës).
- Përmirësimin e cilësisë së të dhënave;
- Shkurtimin e afatit të publikimeve;
- Krijimin e qasjes së ASK-së në sistemin SMIA (MASHT);
- Implementimin e ISCED 2011;
- Implementimin e Klasifikimit Ndërkombëtar të veprave penale për qëllime statistikore;
- Përfundimin e detyrave të projekteve statistikore në kuadër të IPA 2019 (MB)

Departamenti i Statistikave Sociale do të vazhdojë me nxjerrjen e publikimeve të rregullta sipas Kalendarit të Publikimeve 2022.

Në tabelën e mëposhtme kemi pasqyruar listën e publikimeve të pritura gjatë vitit 2022:

Muaji i botimit	Jan	Shku	Mars	Prill	Maj	Qer	Korr	Gusht	Shta	Tet	Nënt	Dhjet
Statistikat e mirëqenies sociale		TM4 2021			TM1 2022			TM2 2022			TM3 2022	
Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore			TM4 2021	2021		TM1 2022			TM2 2022			TM3 2022
Niveli i Pagave					2021							
Statistikat e arsimit						2021/ 2022						
Statistikat e jurisprudencës për persona të mitur						2021						
Statistikat e jurisprudencës për persona madhor									2021			
Statistikat e Kulturës										2021		
Statistikat e Shëndetësisë										2021		
Rezultatet e Anketës TIK në ekonomitë familjare										2022		
Statistikat e Sportit												2021
Rezultatet e Anketës së Kostos së Punës												2021
Rezultatet e Anketës mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës												2021
Statistikat e Lindjeve						2021						
Statistikat e Vdekjeve						2021						
Vlerësimi i Popullsisë						2021						
Statistikat e Kurorëzimeve							2021					
Statistikat e Shkurorëzimeve							2021					
Shkaqet e Vdekjeve												2021
Gratë dhe Burrat në Kosovë												2020/ 2021
Statistikat e Lindjeve Vdekjeve Kurorëzimeve dhe Shkurorëzimeve Janar 2022			Janar 2022									
Statistikat e Lindjeve Vdekjeve Kurorëzimeve dhe Shkurorëzimeve Shkurt 2022				Shkurt 2022								
Statistikat e Lindjeve Vdekjeve Kurorëzimeve dhe Shkurorëzimeve Mars 2022					Mars 2022							
Statistikat e Lindjeve Vdekjeve Kurorëzimeve dhe Shkurorëzimeve Prill 2022						Prill 2022						
Statistikat e Lindjeve Vdekjeve Kurorëzimeve dhe Shkurorëzimeve Maj 2022							Maj 2022					
Statistikat e Lindjeve Vdekjeve Kurorëzimeve dhe Shkurorëzimeve Qershor 2022								Qershor 2022				
Statistikat e Lindjeve Vdekjeve Kurorëzimeve dhe Shkurorëzimeve Korrik 2022									Korrik 2022			
Statistikat e Lindjeve Vdekjeve Kurorëzimeve dhe Shkurorëzimeve Gusht 2022										Gusht 2022		
Statistikat e Lindjeve Vdekjeve Kurorëzimeve dhe Shkurorëzimeve Shtator 2022											Shtator 2022	
Statistikat e Lindjeve Vdekjeve Kurorëzimeve dhe Shkurorëzimeve Tetor 2022												Tetor 2022

Publikimi i të dhënave në kuadër të Departamentit të Statistikave Sociale, bëhet duke shfrytëzuar burimet administrative të të dhënave si dhe të dhënat nga Anketat.

Gjatë vitit 2022 planifikohen të realizohen edhe këto aktivitete:

- Publikimi i Rezultateve të i Anketës së Kostos së Punës;
- Zhvillimi i Anketës për “Arsimimin e të rriturve”;

Po ashtu gjatë vitit 2022 pritet të përfundojnë edhe aktivitetet në kuadër të Projekteve Statistike mbështetur nga IPA 2017:

- Anketa Dhuna në baza gjinore;

### 3.6 Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit

Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit (DSBM) përbehet nga dy Divizione: Divizioni i Statistikave të Bujqësisë dhe Divizioni i Statistikave të Mjedisit.

DSBM është përgjegjës për mbledhjen, analizimin dhe publikimin e Statistikave Zyrtare, të besueshme dhe me kohë për bujqësi, pylltari, statistika agro-monetare dhe të mjedisit, si dhe standardizimin e prodhimit të këtyre statistikave me BE-në.

Më poshtë është lista e publikimeve nga Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit në vitin 2022

Muaji i botimit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi (Tremujor)		TM4/2021			TM1/2022			TM2/2022			TM3/2022	
Indeksi i Çmimeve të Inputeve dhe Çmimet në Bujqësi (Tremujor)		TM4/2021			TM1/2022			TM2/2022			TM3/2022	
Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi (Vjetor)		(2015-2021 Vjetore)										
Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi (Tremujor)		(2015-2021 Vjetore)										
Statistikat e Ujërave në Kosovë 2020-2021			2022									
Anketa e Ekonomive Bujqësore 2021 (vjetore)					2022							
Llogaritjet Ekonomike në Bujqësi 2021 (Vjetore)									2022			
Anketa e Mbeturinave të Trajtuara 2021 (vjetore)										2022		
Anketa e Mbeturinave Komunale 2021 (vjetore)											2022	
Anketa e Mbeturinave Industriale 2021 (vjetore)												2022

*Vëreni se muaji i shkruar në kutinë e hijezuar paraqet muajin e raportuar, përderisa muaji në krye të tabelës paraqet muajin, në të cilin publikimet priten të shpërndahen.*

Për përgatitjen e publikimeve në kuadër të Departamentit të Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit, përfshihen disa faza të punës: përgatitja e mostrës, anketimi i ekonomive bujqësore/mbledhja e të dhënave administrative, përfshirja, kontrolli logjik, përpunimi dhe analiza e të dhënave, përgatitja dhe publikimi i rezultateve, ndërsa proceset rrugore janë të paraqitura në tabelën e mësipërme.

Gjatë vitit 2022 planifikohen të realizohen edhe këto aktivitete:

- Realizimi i pilot-projekteve në kuadër të IPA 2017 dhe-2019:

IPA 2017

- Statistikat e bujqësisë
- Llogaritjet mjedisore.

IPA 2019

- Llogaritë mjedisore dhe pylltaria
- Statistikat e mbeturinave

### **3.7 Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informative**

Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informative përbehet nga dy Divizione: Divizioni i Metodologjisë dhe Shpërndarjes dhe Divizioni i Teknologjisë Informative.

Në Divizionin e Metodologjisë dhe Shpërndarjes për vitin 2020 planifikohen këto aktivitete.:

- Nxjerrjen e mostrave për të gjitha anketat e parashtruara nga statistikatat prodhuese si dhe të hulumtimeve tjera në ASK,
- Nxjerrja e Mostrës për Anketën e Fuqisë Punëtore si dhe Anketën e Ekonomive familjare Bujqësore;
- Nxjerrja e Mostrës për anketën “SILC (Survey on Income and Living Conditions)”
- Nxjerrja e Mostrës për anketën “ICT (Information & Communication Technology Survey)”
- Nxjerrja e Mostrës për Anketën e Turizmit;
- Nxjerrja e Mostrës për Anketën e Buxhetit të Ekonomive Familjare;
- Nxjerrja e Mostrave edhe për Hulumtime tjera shtesë të cilat mundë të kërkohen nga Institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare;
- Llogaritja e Peshave për Hulumtimet dhe Anketat e lartcekura;
- Rivlerësimi i peshave për hulumtimet e ndryshme statistikore;
- Vazhdimi i projektit për Metadata;
- Menaxhimi dhe përmirësimi i Cilësisë statistikore,
- Zbatimin dhe implementimin në praktikë të rekomandimeve sipas standardeve ndërkombëtare dhe EUROSTAT-it për përshkrimin e proceseve statistikore sipas GSBPM dhe modeleve tjera;
- Realizimi i Anketës së Kënaqshmërinë së Përdoruesve



- Ngritja e kapaciteteve profesionale, dokumentimi i metadatave sipas ESMS dhe ESQRS,
- Dokumentimi i të gjitha metodologjive dhe vlerësimet e tyre,
- Do të vazhdohet me përlogaritjen dhe vlerësimin e gabimeve në mostër për të gjitha anketat tjera statistikore,
- Angazhimi në përgatitjet për Regjistrimin e Popullsisë 2022 (Pilot Testi dhe anketa PES);
- Sektori Shpërndarjes do të vazhdojnë të punojë dhe t'i mbështesë departamentet prodhuese, lidhur me kontrollimin dhe përgatitjen e të gjitha publikimeve statistikore, duke zbatuar standardet e Eurostatit, si dhe duke përfshirë këtu edhe shenjëzimin e numrit standard të ISBN-së për të gjitha publikimet vjetore të statistikave.
- Standardizimeve të publikimeve mujore, tremujore dhe vjetore të cilat ka filluar në vitin 2021 do të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2022
- Kalendarit të Publikimeve 2022 do të jetë instrument shumë i rëndësishëm, që sektori i shpërndarjes-desiminimit përgatit dhe bën kontrollimin dhe verifikimin në SIPK programin të afateve kohore të publikimeve, në bazë të deklarimit të datave për publikimin e tyre nga përgjegjësit e departamenteve prodhuese të ASK-së. Po ashtu përgatitjen e Kalendarit të publikimeve për vitin 2023.
- Informimi i shfrytëzuesve për arsyen dhe vonesën e publikimeve është një informatë shtesë ku me këtë lloj informate shfrytëzuesit e të dhënave janë të informuar me kohë lidhur me datën se kurë do të publikohen të dhënat të cilat nuk janë publikuar në afatet e caktuara kohore sipas Kalendarit të Publikimeve.
- Përkthimi i të gjitha publikimeve dhe dokumenteve zyrtare nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe angleze do të jetë punë e këtij sektori edhe gjatë vitit 2022.
- Shpërndarja e publikimeve statistikore, në mënyrë elektronike në adresat e shfrytëzuesve.
- Vazhdimi i publikimeve horizontale tremujore dhe vjetore, të cilat janë si rezultat i statistikave prodhuese do të jenë proces në vazhdimësi për prezantimin e të dhënave kyçe për shfrytëzuesit dhe përdoruesit.
- Vjetari Statistikor i ASK-së, i cili deri në vitin 2021 është publikuar në qershor të vitit referues tani planifikohet të përgatitet gjatë muajit shtator të vitit 2022.
- Katalogu i Publikimeve 2021,
- Kosova në Shifra 2021,
- Buletini Tremujor TM4 2021, TM1 2022, TM2 2022 dhe TM3 2022,
- Buletini Mujor.

Në tabelen e më poshtme janë dhënë disa procese rrugore të disa publikimeve.

Muaji i botimit	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje
Vjetari Statistikor									2022			
Kosova në Shifra						2021						
Buletini tremujor	TM4 2021			TM1 2022			TM2 2022			TM3 2022		
Fletëpalosja e ASK-së												2021
Kalendari i publikimeve të ASK-së											2023	
Kalendari vjetor i ASK-së												2023
Katalogu i publikimeve të ASK-së			2021									

*Vëreni se muaji i shkruar ne kutinë e hijezuar paraqet muajin e raportuar përderisa muaji në krye të tabelës paraqet muajin në të cilin publikimet priten të shpërndahen*

Roli i Teknologjisë Informative (TI) dhe të Sistemit të Informatave Gjeografike (GIS), do të forcohet duke ngritur kapacitetet infrastrukturore dhe njerëzore në mënyrë që të përmbushim objektivat e ASK.

Prioritet për vitin 2022 do të jetë Regjistrimi i Popullsisë 2022. Që të kemi një regjistrim të suksesshëm, zhvillimi dhe avancimi i infrastrukturës së TI-së është parakusht. Roli i TI-së do të jetë i rëndësishëm në të gjitha fazat e Regjistrimit të Popullsisë, veçanërisht teknologjitë e reja që mund të përdoren për aktivitetet e mbledhjes, përpunimit dhe shpërndarjes së të dhënave.

Do ta rrisë bashkëpunimin me ASHI-në, me qëllim që të përfitojmë nga projektet qeveritare përmes e-Qeverisjes, si dhe do të vazhdojë bashkëpunimin me institucionet e tjera, si: MPB, MSH, MASHT, si dhe me institucione të tjera, me qëllim të përmirësimit të sistemit për shkëmbimin e të dhënave statistikore.

Në vazhdimësi, do të mbështeten departamentet e statistikave prodhuese me ofrimin e të dhënave hapësinore, si dhe në krijimin e hartave tematike, me theks të veçantë për Projektin e Regjistrimit të Popullsisë përmes teknologjisë së GIS-it.

Sa i përket teknologjisë për mbledhjen e të dhënave, politikat e ASK do të jenë të orientuara duke shkuar drejt modernizimit të mbledhjes së të dhënave, duke shkurtuar kohën në mbledhjen e të dhënave dhe me cilësi më të lartë, integrimin e këtyre metodave të reja për të forcuar programet statistikore të mbledhjes së të dhënave të ASK-së si dhe duke lehtësuar në përpunimin më të shpejtë dhe të automatizuar të të dhënave, eliminimi i pyetësorë të letrës si dhe eliminimi i nevojës për staf të dedikuar për futjen e të dhënave, kosto më e lirë etj.

Objektivi është 100 % e anketave në terren të dhënave mblidhen përmes metodës CAPI dhe CAËI.

Sistemi i me metadatave SIMS (Single Integrated Metadata Structure) i cili është në zhvillim e sipër sipas standardeve të Eurostat do të avancohet. Përmes këtij sistemi, menaxhimi dhe shpërndarjen e metadatave do të bëhet përmes ueb faqes së ASK dhe të njëjtat mund të gjenerohen në formatin SDMX për transmetim në Eurostat përmes platformës së tyre Metadata Handler.

SIMS do të përdoren edhe për institucionet tjera si Ministria e Financave dhe Banka Qendrore. Në përputhje me rekomandimet e Eurostat-it vazhdon avancimi i mëtejme i platformës ASKdata, e krijuar për menaxhimin dhe shpërndarjes së të dhënave online për të gjithë shfrytëzuesit.

Do të ketë fuqizim të mëtejme të sistemit të GIS-it për menaxhimin e të dhënave gjeo-hapësinore si dhe përdorimi i tyre për zhvillimin e anketave të ndryshme në terren.

Integrimi dhe segmentimi i qarqeve për nevoja të regjistrimit si dhe anketave tjera të rregullta duke u bazuar nga të dhënat Azhurnimit 2020.

Do të promovohet platforma ASKdata edhe në institucione tjera qeveritare me qëllim që ky sistem të jetë si platformë unike për shpërndarjen por edhe për shkëmbimin e të dhënave.

Zhvillimi i mëtejme i ueb faqes së re do të vazhdojë, ku parashihet lidhja me ueb aplikacione, shpërndarja e metadatave sipas standardeve të Eurostat-it, formati ESMS si dhe zhvillimi i veglave për vizualizim dhe krijimin e Infografeve.

Zbatimi dhe integrimi i SharePoint në ASK, si dhe zhvillimi i mëtejme i Sistemit të Përfshirjes së Kohës (SIPK) do të vazhdojë edhe në vitin 2022.

Do vazhdohet mbështetja e departamenteve prodhuese në transmetimin e të dhënave sipas standardeve të Eurostat-it, sistemi eDAMIS.

Zbatimi dhe integrimi i SharePoint në ASK, si dhe zhvillimi i mëtejme i Sistemit të Përfshirjes së Kohës (SIPK) do të vazhdojë edhe në vitin 2022.

Do vazhdohet mbështetja e departamenteve prodhuese në transmetimin e të dhënave sipas standardeve të Eurostat-it, sistemi eDAMIS.

### **3.8 Departamenti i Anketimeve dhe Regjistrimeve**

Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve (DRA) është përgjegjës për mbledhjen e të dhënave statistikore përmes raporteve dhe anketave të planifikuara nga departamentet prodhuese të ASK-së. Ky departament sfidë në vazhdimësi do të ketë ngritjen e cilësisë së mbledhje së të dhënave sipas kritereve dhe standardeve, shkurtimin e kohës me qëllim të rritjes së cilësisë dhe efikasitetit gjatë mbledhjes së të dhënave .

DAR ka nën menaxhimin e vet shtatë (7) Zyrrat Rajonale të ASK-së. DRA bënë menaxhimin, mbikëqyrjes dhe kontrollin e punëve dhe aktiviteteve operative të Zyrrave Rajonale të ASK-së lidhur me mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave në terren.

DAR gjatë periudhës 2018 -2022 ka filluar me mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave me mjete dhe pajisje të TI-së, ku si mjete përdoren Tabletat dhe ku të dhënat gjatë anketimeve shkarkohen direkt në bazat e veçanta të Serverëve të ASK-së. Qëllimi kryesor është zhvillimi i praktikave dhe standardeve të avancuara, si dhe ngritja e cilësisë së të dhënave, duke bërë shkurtimin e kohës së grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave për departamentet prodhuese. Gjatë vitit 2020 është planifikuar që shumica e hulumtimeve të realizohen me metodën CAPI.

DRA në vitin 2020 në bashkëpunim me departamentet prodhues dhe tjera do të shtojë monitorimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e punëve dhe aktiviteteve gjatë realizimit të mbledhjes, grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave me qëllim të rritjes së sasisë dhe cilësisë së të dhënave të cilat ndikojnë në prodhimin e statistikave të besueshme të ASK-së për institucione vendore, ndërkombëtare dhe përdorues të tjerë.

Për realizimin e punëve dhe aktiviteteve në bazë të dinamikës së Planit dhe Programit të ASK-së për vitin 2021 , DRA do t'i përgatisë raportet praktike ditore, javore, mujore dhe vjetore mbi ecurinë në realizimin detyrave dhe zhvillimin e aktiviteteve në bazë të afateve të planifikuara për vitin 2021 .

### **3.9 Departamenti i Administratës**

Departamenti i Administratës është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve administrative ditore në ASK, si: operacione financiare, kontabilitet, administrimi i procedurave për projekte të ndryshme si dhe zbatimin e procedurave të sistemit të Thesarit, furnizime, logjistikë, etj. Po ashtu gjatë vitit 2022 do të bëjmë përgatitjen e pasqyrave financiare, raporteve mujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetore. Bënë menaxhimin e kontratave për pagesa , menaxhimin e aseteve, pronës dhe shërbimeve të logjistikës.

Një prej pikave kyçe do të jetë zbatimin e Planit të Vjetor 2022, si dhe respektimi i të gjitha procedurave, gjegjësisht legjislacionit në fuqi, në funksion të menaxhimit të aktiviteteve të lartcekura.

## 4. SFIDAT

Sfidat me të cilat pritet të ballafaqohet ASK-ja janë:

- Realizimi i anketave për shkak të pandemisë COVID - 19
- Realizimi i programit të punës (publikimet në kohë), në mungesë të stafit për mos-prani të zyrtarëve në punë (në zbatim të masave mbrojtëse)
- zbatimi i Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022 (PSZ);
- zbatimi i Planit Kombëtar për MSA-në, në fushën e statistikave;
- sigurimi i indikatorëve, gjegjësisht monitorimi i strategjisë SEE 2020 dhe SDG;
- përmirësimi i vazhdueshëm i të dhënave statistikore;
- krijimi i një sistemi unik statistikor të TI-së;
- zbatimin e Kornizës së Vlerësimit të Performancës së PVSZ (për disa indikatorë);
- kuadri i burimit të të dhënave, ende i pamjaftueshëm
- harmonizimi i statistikave ndërmjet ASK-së dhe ministrive, që janë prodhues të statistikave;
- Plotësimi i pozitave të lira (pozitat e zyrtarëve që e kanë lëshuar punën dhe atyre që janë pensionuar
- Sigurimi i buxhetit të mjaftueshëm për realizimin e Projektit të Regjistrimit të Popullsisë 2022.
- implementimi i pilot-projekteve IPA 2015 dhe IPA 2017 dhe projektet me donatore tjerë.

## 5. SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE DHE QASJA

- Azhurnimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i platformës për shpërndarjen e bazës së shënimeve ASKData do të vazhdojë, pasi objektivi i ASK-së është që edhe gjatë vitit 2022, ASKData të jetë kanali kryesor i shpërndarjes së të dhënave.
- Ofrimi i të dhënave statistikore në ueb-faqen e ASK-së në formatin PDF, Excel për të gjitha departamentet statistikore.
- Standardizimi i publikimeve Mujore, Tremujore dhe Vjetre sipas standardeve.

DATA E PUBLIKIMIT	TITULLI I PUBLIKIMIT	PERIUDHA
<b>JANAR</b>		
11 janar 2022	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Dhjetor 2021)
25 janar 2022	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Dhjetor 2021)
28 janar 2022	Repertori Stat. mbi Ndër. Ekon. në Kosovë	(TM4/2021)
28 janar 2022	Statistikat e Transportit	(TM4/2021)
31 janar 2022	Buletini Tremujor	(TM4/2021)
<b>SHKURT</b>		
04 shkurt 2022	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në Bujqësi	TM4/2021
11 shkurt 2022	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM4/2021
14 shkurt 2022	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM4/2021
16 shkurt 2022	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Janar 2022)
18 shkurt 2022	Statistikat e Mirëqenies Sociale	TM4/2021
18 shkurt 2022	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në Bujqësi	(2015-2021)
25 shkurt 2022	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(janar 2022)
28 shkurt 2022	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi	(2015-2021)
<b>MARS</b>		
04 mars 2022	Indeksi i Çmimeve të Importit	TM4/2021
04 mars 2022	Statistikat e Hotelarisë	TM4/2021
04 mars 2022	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM4/2021
04 mars 2022	Llogaritë Qeveritare	TM4/2021
10 mars 2022	Indeksi i Kostos së Ndërtimit	TM4/2021
11 mars 2022	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Shkurt 2022)
12 mars 2022	Indeksi i Kostos së Ndërtimit	TM4/2021
15 mars 2022	Statistikat Afatshkurtra të Industrisë	TM4/2021
15 mars 2022	Katalogu i Publikimeve të ASK-së	2021
16 mars 2022	BPV me Qasjen e Shpenzimeve dhe Prodhimit	TM4/2021
16 mars 2022	Statistikat Afatshkurtra të Tregëtisë me Pakicë	TM4/2021
17 mars 2022	Statistikat e Lind, Vdek, Kuror dhe Shkur	(janar 2022)
18 mars 2022	Anketa së Fuqisë Punëtore	TM4/2021
18 mars 2022	Statistikat e Ujërave në Kosovë	2020/2021
22 mars 2022	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Shkurt 2022)
31 mars 2022	Statistikat Afatshkurtra të shërbimëve	TM4/2021

<b>PRILL</b>		
01 prill 2022	Anketa së Fuqisë Punëtore	2021
12 prill 2022	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Mars 2022)
15 prill 2022	Statistikat e Lind, Vdek, Kuror dhe Shkur	(Shkurt 2022)
22 prill 2022	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Mars 2022)
29 prill 2022	Repertori Stat. mbi Ndër. Ekon. në Kosovë	TM1/2022
29 prill 2022	Statistikat e Transportit	TM1/2022
29 prill 2022	Buletini Tremujor	TM1/2022
<b>MAJ</b>		
06 maj 2022	Llogaritë Qeveritare	2021
06 maj 2022	Indeksi i Çmim. të Prodhimeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM1/2022
11 maj 2022	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Prill 2022)
12 maj 2022	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM1/2022
12 maj 2022	Indeksit Çmimeve të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM1/2022
13 maj 2022	Statistikat e Lind, Vdek, Kuror dhe Shkur	(Mars 2022)
20 maj 2022	Statistikat e Mirëqenjes Sociale	TM1/2022
23 maj 2022	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Prill 2022)
27 maj 2022	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	2021
27 maj 2022	Niveli i Pagave	2021
27 maj 2022	Anketa e Ekonomive Bujqësore	2021
<b>QERSHOR</b>		
03 qershor 2022	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	2021
03 qershor 2022	Llogaritë Qeveritare	TM1/2022
03 qershor 2022	Statistikat e Hotelisë	TM1/2022
03 qershor 2022	Indeksi i Çmimve të Importit	TM1/2022
06 qershor 2022	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM1/2022
08 qershor 2022	Indeksi i Kosotos së Ndërtimit	TM1/2022
08 qershor 2022	Statistikat e Lindjeve në Kosovë	2021
10 qershor 2022	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Maj 2022)
10 qershor 2022	Statistikat e Arsimit	2021/2022
14 qershor 2022	Statistikat Afatshkurtra të Industrisë	TM1/2022
15 qershor 2022	Statistikat e Vdekjeve	2021
15 qershor 2022	Statistikat Afatshkurtëra të Tregtisë me pakicë	TM1/2022
15 qershor 2022	BPV me Qasjen e Shpenzimeve dhe Prodhimit	TM1/2022
15 qershor 2022	Statistikat e Lind, Vdek, Kuror dhe Shku	(Prill 2022)
15 qershor 2022	Kosova në Shifra	2021
18 qershor 2022	Anketa e Fuqisë Punëtore	TM1/2022
22 qershor 2022	Vlerësimi i Popullsisë	2021
23 qershor 2022	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Maj 2022)

24 qershor 2022	Bilanci i Energjisë në Kosovë	2021
24 qershor 2022	Statistikat e Jurisprudencës për Persona të Mitur	2021
29 qershor 2022	Statistikat Afatshkurtra të Shërbimëve	TM1/2022
<b>KORRIK</b>		
06 korrik 2022	Statistikat e Kurorëzimeve në Kosovë	2021
12 korrik 2022	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Qershor 2022)
13 korrik 2022	Statistikat e Shkurorëzimeve në Kosovë	2021
13 korrik 2022	Statistikat e Lind, Vdek, Kuror dhe Shkur	(Maj 2022)
22 korrik 2022	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Qershor 2022)
29 korrik 2022	Statistikat e Transportit	TM2/2022
29 korrik 2022	Repertori Stat. mbi Ndër. Ekon. në Kosovë	TM2/2022
29 korrik 2022	Buletini Tremujor	TM2/2022
<b>GUSHT</b>		
05 gusht 2022	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në Bujqësi	TM2/2022
11 gusht 2022	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Korrik 2022)
12 gusht 2022	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi)	TM2/2022
12 gusht 2022	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM2/2022
15 gusht 2022	Statistikat e Lind, Vdek, Kuror dhe Shkur	(Qershor 2022)
19 gusht 2022	Statistikat e Mirëqenjes Sociale	TM2/2022
23 gusht 2022	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Korrik 2022)
<b>SHTATOR</b>		
02 shtator 2022	Indeksi i Çmimeve të Importit	TM2/2022
02 shtator 2022	Statistikat e Hotelarisë	TM2/2022
02 shtator 2022	Statistikat e Jurisprudencës për Persona Madhor	2021
02 shtator 2022	Llogaritë Qeveritare	TM2/2022
02 shtator 2022	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM2/2022
02 shtator 2022	Llogaritjet Ekonomike në Bujqësi	2021
07 shtator 2022	Indeksi i Kostos së Ndertimit	TM2/2022
09 shtator 2022	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Gusht 2022)
13 shtator 2022	Statistikat Afatshkurtra të Industrisë	TM2/2022
14 shtator 2022	Statistikat Afatshkurtra të Tregtisë me Pakicë	TM2/2022
15 shtator 2022	BPV me Qasjen e Shpenzimevet dhe Prodhimit	TM2/2022
15 shtator 2022	Statistikat e Lind, Vdek, Kuror dhe Shkur	(Korrik 2022)
16 shtator 2022	Anketa e Fuqisë Punëtore	TM2/2022
20 shtator 2022	BPV me Qasjen e Shpenzimevet dhe Prodhimit	2021
23 shtator 2022	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Gusht 2022)
28 shtator 2022	Statistikat Afatshkurtra të Shërbimëve	TM2/2022
30 shtator 2022	Statistikat e Shëndetësisë	2021
30 shtator 2022	Vjetari Statistior	2022
<b>TETOR</b>		



11 tetor 2022	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Shtator 2022)
14 tetor 2022	Statistikat e Kulturës	2021
14 tetor 2022	Statistikat e Lind, Vdek, Kuror dhe Shkur	(Gusht 2022)
14 tetor 2022	Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit	2020
20 tetor 2022	Anketa e Mbeturinave të Trajtuara	2021
21 tetor 2022	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Shtator 2022)
28 tetor 2022	Repertori Stat. mbi Ndër. Ekon. në Kosovë	TM3/2022
28 tetor 2022	Statistikat e Transportit	TM3/2022
37 tetor 2022	Buletini Tremujor	TM3/2022
<b>NËNTOR</b>		
04 nëntor 2022	Indeksi i Çmim. të Prodhimeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM3/2022
11 nëntor 2022	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM3/2022
11 nëntor 2022	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Tetor 2022)
11 nëntor 2022	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM3/2022
15 nëntor 2022	Statistikat e Lind, Vdek, Kuror dhe Shkur	(Shtator 2022)
16 nëntor 2022	Anketa e TIK-ut në Biznese	2021
18 nëntor 2022	Statistikat e Mirëqenies Sociale	TM3/2022
18 nëntor 2022	Anketa e Investimeve në Biznese	2021
18 nëntor 2022	Anketa e Mbeturinave Komunale	2021
22 nëntor 2022	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Tetor 2022)
25 nëntor 2022	Kalendari i Publikimeve të ASK-së	2023
30 nëntor 2022	Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve	2021
<b>DHJETOR</b>		
02 dhjetor 2022	Rezultatet e Anketës së PRODCOM	2021
02 dhjetor 2022	Indeksi i Çmimeve të Importit	TM3/2022
02 dhjetor 2022	Statistikat e Hotelerisë	TM3/2022
02 dhjetor 2022	Llogaritë Qeveritare	TM3/2022
06 dhjetor 2022	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM3/2022
08 dhjetor 2022	Indeksi i Kostos së Ndërtimit	TM3/2022
09 dhjetor 2022	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Nëntor 2022)
09 dhjetor 2022	Gratë dhe Burrat në Kosovë	2021/2022
13 dhjetor 2022	Statistikat Afatshkurtra të Industrisë	TM3/2022
14 dhjetor 2022	Statistikat Afatshkurtra të Tregtisë me Pakicë	TM3/2022
15 dhjetor 2022	Statistikat e Lind, Vdek, Kuror dhe Shkur	(Tetor 2022)
15 dhjetor 2022	BPV me Qasjen e Shpenzimeve dhe Prodhimit	TM3/2022
16 dhjetor 2022	Anketa e Fuqisë Punëtore	TM3/2022
19 dhjetor 2022	Statistikat e Sportit	2021
20 dhjetor 2022	Shkaqet e Vdekjeve në Kosovë	2021
20 dhjetor 2022	Kalendari i ASK	2023
20 dhjetor 2022	Anketa e Mbeturinave Industriale	2021

22 dhjetor 2022	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Nëntor 2022)
29 dhjetor 2022	Rezultatet e Anketës së Kostos së Punës	2020
29 dhjetor 2022	Statistikat Afatshkurtra të Shërbimëve,	TM3/2022
30 dhjetor 2022	Rezultatet e Anketës mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës	2021

## 6. BUXHETI

Për periudhën e përmendur të Hartës Rrugore 2022, buxheti për ASK-së është si në vijim:

### Buxheti për ASK 2022

Buxheti 2022	€
Pagat & Mëditje	1,088,394.00
Mallrat dhe Shërbimet	7,511,464.00
Shpenzimet kosto	21,875.00
<b>TOTAL:</b>	<b>8,621,733.00</b>
Numri i punëtorëve	166

\*Shënim:

- Buxheti sipas Projekt Ligjit mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës vitin 2022 për ASK është paraparë në vlerë 8,621,733.00.
- Në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime është i përfshirë edhe buxheti për Regjistrim të Popullsisë.
- Kërkesat e ASK-ës për buxhet shtese 2022 janë 2,508,506.00 € për buxhetin e Regjistrimit të Popullsisë. Buxheti shtese është kërkuar sipas kategorive ekonomike si me poshtë:

Mallra & shërbime	2,010,506.00
Komunale	18,000.00
Kapitale	480,000.00

Aneksi 1 - Organogrami i ASK-së



